



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.Dh.Sh.II.nr.90/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Gjiilan, kundër debitorit “Ceni Group” SH.P.K., me adresë “Fidanishtja” p.nr. në Gjiilan, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga Hamdi Jashari avokat me seli në Gjiilan, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2573/2022 të datës 31.10.2023, me datë 08.05.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e debitorit “Ceni Group” SH.P.K., me adresë “Fidanishtja” p.nr. në Gjiilan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2573/2022 i datës 31.10.2023, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2573/2022 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Ceni Group” SH.P.K., me seli në Gjiilan, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.702/2022 të datës 15.11.2022 të përmbartuesit privat Kushtrim Musa me seli në Gjiilan. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor P.nr.702/2022 të datës 15.11.2022 të përmbartuesit privat Kushtrim Musa me seli në Gjiilan.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Inspektorati i Punës, me seli në Gjilan, me datë 15.11.2022 ka paraqitur propozim për përmbarrim kundër debitorit “Ceni Group” SH.P.K., me adresë “Fidanishtja” p.nr. në Gjilan, në bazë të dokumentit përmbarrues - Vendimit Nr.02/C-42/2021 të datës 23.12.2021, i formës së prerë nga data 21.09.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 21.09.2022.

Përmbarruesi privat Kushtrim M. Musa, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.702/2022 të datës 15.11.2022, ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrues, duke vlerësuar se dokumenti përmbarrues i plotëson kushtet për përmbarrim.

Kundër këtij urdhri përmbarrimor debitori me datë 22.11.2022 ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se ka ushtruar padi për anulimin e vendimit, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet - shfuqizohet urdhri ose të aprovohet prapësimi dhe të prishet urdhri dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datë 06.12.2022, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se dokumenti përmbarrues i dhënë në procedurë administratave i ka kaluar të gjitha instancat e përcaktuara me dispozita ligjore të përcaktuara me Ligjin e Inspektoratit të Punës Nr.03/L-017, për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Inspektorat të Punës nr.2209/9, i njëjti aktvendim është bërë i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë po ashtu është pajisur me klauzolën e përmbarrueshmërisë. Andaj, ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi dhe të vërtetohet urdhri.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2573/2022 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Ceni Group” SH.P.K., me seli në Gjilan, i ushtruar kundër urdhrin përmbarrimor P.nr.702/2022 të datës 15.11.2022 të përmbarruesit privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan. Në pikën II të dispozitivit ka lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor P.nr.702/2022 të datës 15.11.2022 të përmbarruesit privat Kushtrim Musa me seli në Gjilan. Në arsyetimin të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për arsye se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin në mbështetje të nenit 22, 23 paragrafi 2 dhe 24 paragrafi 3 të LPP-së, se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 36 paragrafi 1 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësojnë edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Nr.02/C-42/2021 i datës 23.12.2021, i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm nga data 21.09.2022, për shumën e detyrimit prej 8,000.00 Euro, në këtë rast është dokument përmbarues, e kjo përcaktohet me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, me të cilën parashihet se: *“Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”*, dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës procedurale dhe zbatim të gabuar të ligjit material, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit as për shkelje tjera të pretenduara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit nuk ka gjetur se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së për aprovim të prapësimit.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Në këtë rast debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike për refuzimin e prapësimit si të pabazuar.

Në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoi përmbarimin.

Nga ana e debitorit janë ngritur edhe pretendime tjera të cilat nuk janë pranuar si të themelta, sepse në procedurën përmbarimore gjykata i përmbahet parimit të rigorozitetit formal - juridik që nënkupton se vlerëson vetëm rrethanat nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit dhe shkaqet që mund të përbejnë bazë të mjaftueshme për prapësim, ndërsa nuk lëshohet fare në vlerësimin e veprimeve që i referohen procedurës në të cilën është marr dokumenti përmbarimor.

Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret vendimi i lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të punës Nr.02/C-42/2021 i datës 23.12.2021, është dokument përmbarimor dhe i përmbarueshëm dhe cilësia e tillë është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata ankimore vlerëson se me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LPP - së, përcaktohet se “Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: “Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”. Në kuptim të kësaj dispozite vendimi si dokument përbarimor, ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe është i përbarueshëm, pasi që i njëjti është pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën për ekzekutueshmëri, andaj konform nenit 36 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, përbarimi në këtë rast është i lejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.Dh.Sh.II.nr.90/2024 me datë 08.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha